

**V E N D I M**  
**Nr.266, datë 24.4.2003**

**PËR ADMINISTRATAT E ZONAVE TË MBROJTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave të përcaktojë për parqet kombëtare dhe rezervatet natyrore të menaxhuara (zonat e mbrojtura të kategorive II e IV) administratën e mbrojtjes së tyre, nga stafi i drejtorive të saj në rrethe. Numri i punonjësve të administratës për secilën zonë caktohet në përputhje me statusin, nivelin e saj të mbrojtjes dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit.

2. Administrata e këtyre zonave është në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe e Kullotave dhe trajtimi financiar i punonjësve të saj është i njëjtë me atë të punonjësve të drejtorive të shërbimit pyjor në rreth.

3. Administrata e zonës së mbrojtur përgjigjet edhe për monumentet e natyrës, që ka rrethi, pavarësisht nëse ato ndodhen ose jo në territorin e zonës së mbrojtur.

4. Administrata e zonës së mbrojtur kryen këto detyra dhe shërbime:

- a) administron zonat e mbrojtura;
  - b) ruan zonat e mbrojtura (funksion policie);
  - c) ndjek zbatimin e planit të menaxhimit të zonës;
  - ç) ndjek realizimin e programeve vjetore të monitorimit e të biomonitorimit të zonës, në bashkëpunim me institute e katedra të specializuara të ngarkuara me monitorimin dhe publikimin e të dhënave;
  - d) harton rregulloren për administrimin dhe ruajtjen e zonës dhe rregulloret vendore për peshkimin, për gjuetinë, për mbrojtjen e pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore, ku zona ka të tilla;
  - dh) gjëbërit në raste kundërvajtjesh dhe vjel gjëbat;
  - e) grumbullon tarifat për përdorimin dhe shfrytëzimin e zonave të mbrojtura;
  - ë) kontakton përdoruesit e të gjitha llojeve;
  - f) kontrollon përdoruesit dhe vizitorët;
  - g) zbaton infrastrukurën e domosdoshme për përdorimin e zonave të mbrojtura;
  - gj) ndërton skedar rajonal mjedisor, si pjesë e skedarit kombëtar;
  - h) përdor me frytshmëri fondet për mirëmbajtjen e zonës;
  - i) publikon çdo vit të dhënat për gjendjen e zonës;
  - j) dokumenton veprimtaritë, investimet, kërkimet shkencore të kryera në zonë;
  - k) përgatit dhe publikon çdo fundviti raportin vjetor të gjendjes së zonës dhe e paraqet në Ministrinë e Mjedisit, në DPPK dhe në organet qeverisjes vendore;
  - l) bashkëpunon me institucione kërkimore shkencore, me OJF-të mjedisore dhe me komunitetin për mbrojtjen e zonës dhe ruajtjen e biodiversitetit të saj;
  - ll) organizon, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, me institucionet kërkimore-shkencore, me institucionet arsimore e kulturore, me OJF-të mjedisore, si dhe me komunitetin veprimtar ndërgjegjësues dhe bën botime të ndryshme, për të bërë të njohura vlerat e zonës;
  - m) bashkërendon festimin e ditëve dhe ndodhive mjedisore që lidhen me zonën.
5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave (DPPK) për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**